

VENDIM
Nr. 434, datë 8.6.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 1353, DATË 10.10.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PARAQITJEN E KËRKESËS, MBAJTJEN DHE PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK, SI DHE TË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË ZVOGËLIMIT TË SIPËRFAQES E TË VËLLIMIT TË FONDIT PYJOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, date 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1353, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë vendimin bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) emërtimi “organe të qeverisjes vendore” zëvendësohet me “bashki”;
 - b) emërtimi “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministria e Mjedisit”;
 - c) emërtimi “Drejtori Rajonale e Shërbimit Pyjor” zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki”;
 - ç) termi “pyje komunale” zëvendësohet me “pyje bashkiake”.
2. Pas shkronjës “c”, të pikës 5, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor nga ana e kryetarit të bashkisë, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore, e cila do t’i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor.”.
3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki identifikimin e ngastrave e të nënngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave nga data e marrjes së kërkesës. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data që ajo e ka kërkuar.”.
4. Pika 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

“11. Vlera e sipërfaqes pyjore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 8, të këtij vendimi, dhe derdhet në llogarinë bankare të bashkisë, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore e cila do t’i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor.”.
5. Pika 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

“16. Kur kërkesa bëhet sipas përcaktimit të pikës 14, ajo shqyrtohet nga Ministria e Mjedisit brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Pas këtij afati ajo quhet e miratuar. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe ministria bëjnë përditësimet në kadastrën e pyjeve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi